

Politikat dhe Procedurat Standarde

për

Rekrutimin e Ushtarëve Profesionistë

në

Forcat e Armatosura

Përmbajtja

Referencat	fq 3
1. Politikat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë.....	fq 4
2. Përgjegjësitë dhe procedurat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë.....	fq 5
2.1. Përgjegjësitë e strukturave.....	fq 5
2.2. Procedurat e planifikimit.....	fq 5
2.3. Kriteret për rekrutimin e ushtarëve profesionistë.....	fq 6
2.4. Procedurat e aplikimit për ushtar profesionist	fq 7
2.5. Dokumentet e nevojshme për regjistrimin e kandidatëve për ushtarë profesionistë.....	fq 7
2.6. Kontrolli, përzgjedhja dhe pranimi për ushtarë profesionistë.....	fq 7
2.7. Procedura e zgjidhjes së ankesave.....	fq 8
2.8. Procedurat e titullimit dhe emërimit të ushtarit profesionist.....	fq 9

Referencat :

- Ligji Nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura të RSH”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9171 date 22.01.2004, “Për Gradat dhe Karrierën Ushtarake në FA të RSH”.
- Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 9210 datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të RSH”.
- Ligji Nr 9858, datë 27.12.2007 “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”.
- Dekreti i Presidentit të Republikës Nr. 6357 datë 09.12.2009 ”Për miratimin e Strukturës së Forcave të Armatosura të RSH”.
- Dekreti i Presidentit të Republikës Nr. 6358 datë 09.12.2009 “Për miratimin e planit të përhapjes së Forcave të Armatosura të RSH”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 554 datë 02.07.2004 “Për njehsimin e gradave ushtarake me funksionet organike në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit dhe të drejtimit të Forcave të Armatosura të RSH”.
- Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes Nr 1353, datë 16.07.2010 “Për menaxhimin e personelit n/oficer, ushtar profesionist dhe civil në repartet autonome të Shtabit të Përgjithshëm të FA, Brigadës Logjistike dhe Brigadës së Mbështetjes Rajonale”.
- Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes Nr 2101, datë 17.11.2010 “Procedurat standarde të emërimit dhe kohëqëndrimit në detyrë të personelit të strukturave në FA”.

1. Politikat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë

Me kalimin e FASH në forcë tërësisht vullnetare profesioniste, është themelore që personeli i rekrutuar të ketë cilësitë më të larta për të shërbyer në Forcat e Armatosura. Do të rekrutojmë ushtarë profesionistë që kanë njohuritë e nevojshme në përputhje me kërkesat e pozicioneve të punës, në funksion të specialiteteve përkatëse, duke përmirësuar ndërkohë procedurat dhe praktikatat e pranimit, duke u dhënë përparësi individëve me arsim më të lartë dhe me aftësi e cilësi unike për specialitete të veçanta.

Rekrutimi i ushtarëve profesionistë siguron prurje të rinjsh, gjë që është thelbësore për një forcë të armatosur për të funksionuar në mënyrë efikente.

Rekrutimi për t'u bërë ushtar profesionist në Forcat e Armatosura do të ofrojë shanse të barabarta, mosdiskriminim për shkak racës, etnisë, ngjyrës, gjinisë, përkatësisë fetare, si dhe pagë, përfitime dhe kompensime të tjera sipas veçorive të shërbimit ushtarak.

Rekrutimi i ushtarëve profesionistë për plotësimin e strukturave të Forcave të Armatosura do të bëhet në mënyrë të përqëndruar.

Rekrutimi i ushtarëve profesionistë për misionet dhe sfidat e reja që do të përballojnë Forcat tona të Armatosura do të bëhet duke ruajtur e zhvilluar balancat midis kërkesës për moshë mesatare sa më të re në Forcat e Armatosura dhe nevojës për të qëndruar më gjatë se deri tani në shërbimin ushtarak; raporte të arsyeshme midis forcave operacionale e forcave mbështetëse; midis strukturave të shtabeve me trupën, me qëllim përzgjedhjeje sa më efektive nga kontigjentet që aplikojnë për të shërbyer në Forcat e Armatosura. Personeli ushtar profesionist femër në Forcat e Armatosura do të përbëjë deri 15 % të numrit të përgjithshëm të tyre dhe për çdo strukturë veç e veç, në funksion të misioneve dhe detyrave sipas niveleve operacionale të kërkuara.

Përzgjedhja e elementeve më të përshtatshëm do të bëhet mbi bazën e testimeve për gjendjen shëndetësore, aftësitë fizike dhe intelektuale sipas standardeve e procedurave të përcaktuara për këtë qëllim. Shtabi i Përgjithshëm i FA do të rishikojë testet në Nëntor të çdo viti dhe do t'i përshtasë ato në përputhje me realizimin e nevojave të forcës për personel. Duke filluar nga viti 2012, do të zgjerojmë gjithashtu kategoritë e testit intelektual për të matur aftësitë individuale plotësuese sipas kërkesave për çdo specialitet.

Kontrata e shërbimit për ushtarët profesionistë është përgjegjësi e institucionit të Forcës së Armatosur, e përfaqësuar nga nivelet përkatëse të komandimit. Për këtë do të zhvillohen e miratohen procedura standarde sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

2. Përgjegjësitë dhe procedurat e rekrutimit të ushtarëve profesionistë:

2.1 Përgjegjësitë e strukturave:

- 2.1.1. Drejtoria e Personelit, Drejtoria e Operacioneve dhe Stërviutjes, Drejtoria e Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes dhe Drejtoria e Bashkëpunimit Civilo Ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të FA, në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave dhe Planifikimit Strategjik, Drejtorinë e Menaxhimit dhe Kualifikimit të Personelit, në MM, ndjekin dhe bashkërendojnë gjithë procesin e planifikimit dhe rekrutimit të ushtarëve profesionistë.
- 2.1.2. Qendra e Personel Rekrutimit (QPR) është struktura përgjegjëse e cila ka për mision rekrutimin e ushtarëve profesionistë në Forcat e Armatosura.
- 2.1.3. QPR, mbi bazën e planit vjetor të rekrutimit të detajuar me specialitete dhe kuota numerike të miratuar nga Shtabi i Përgjithshëm i FA (SHPFA), e ndan atë sipas Qendrave të Rekrutimit në Prefektura.
- 2.1.4. Komandat e Forcave, Komanda e Brigadës Logjistike, Komanda e Brigadës së Mbështetjes Rajonale, Komanda e Doktrinës dhe Stërviutjes si dhe komandat e njësisve dhe repartet në vartësi të drejtëpërdrejtë mbështesin QPR në veprimtarinë e saj.
- 2.1.5. QPR, organizon marketingun për rekrutimin e ushtarëve profesionistë në Forcat e Armatosura, duke bashkëpunuar me komandat e reparteve, Qendrën e Kulturës e Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe organet e pushtetit lokal, shkollat civile të mesme e të larta dhe mediat e ndryshme elektronike e të shkruara.
- 2.1.6. Komandat e të gjitha niveleve ndërmarrin masa për prezantimin e vlerave, mundësive e përfitimeve që ofron rekrutimi ushtar profesionist në Forcat e Armatosura.

2.2 Procedurat e planifikimit për ushtarë profesionistë

- 2.2.1. Në muajin prill - maj të çdo viti, Komandat e Forcave, Komanda e Brigadës Logjistike, Komanda e Brigadës së Mbështetjes Rajonale, Komanda e Doktrinës dhe Stërviutjes, Komanda e Regjimentit të Mbështetjes, reparteve dhe strukturave të tjera, paraqesin pranë Drejtorisë së Personelit në Shtabin e Përgjithshëm nevojat dhe kërkesat për kompletimin e Tabelave të Organizimit dhe Pajisjeve me ushtarë profesionistë për vitin pasardhës sipas prioriteteve, specialiteteve dhe kërkesave për përmbushjen e niveleve operacionale.
- 2.2.2. Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA, jo më pak se një vit përpara, harton planin e rekrutimit mbi bazën e prioriteteve të përcaktuara, specialiteteve, nevojave, kuotave numerike për çdo forcë, njësi e repart. Plani i rekrutimit miratohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.
- 2.2.3. Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA, bazuar në të dhënat e dërguara nga Komandat e Forcave, njësisve e reparteve për ushtarët profesionistë dhe nënoficerët që plotësojnë kriteret ligjore për nxjerrje në rezervë /lirim, duke përfshirë edhe arësytën e

nxjerrjes në rezervë/lirim të mbajë ato me hollësi për çdo muaj, duke filluar nga muaji janar i vitit 2011 e në vijim.

- 2.2.4. Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm, në muajin Qershor, dërgon planin e rekrutimit në QPR dhe në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes për të planizuar Stërvitjen Individuale të Avancuar në bazë të kapaciteteve stërvitore.
- 2.2.5. QPR, në bazë të kapaciteteve që ofron KDS, bën rekrutimin e kandidatëve për ushtarë profesionistë për kompletimin e strukturave të forcave, njësisve dhe reparteve të Forcave të Armatosura. Në fillim të bëhet planifikimi për Stërvitjen Individuale të Avancuar dhe mbi këtë bazë të bëhet planizimi për Stërvitjen Bazë. QPR, brenda muajit Tetor, bën shpërndarjen e këtij plani dhe e dërgon në Qendrat e Rekrutimit sipas Prefekturave.
- 2.2.6. Procesi i pararekrutimit vijon gjatë gjithë vitit, por rekrutimi të bëhet në mënyrë të përqendruar në bazë të specialiteteve dhe në përputhje me planizimin që KDS ka bërë për zhvillimin e Stërvitjes Individuale të Avancuar dhe Stërvitjes Bazë.
- 2.2.7. QPR dhe KDS të bashkërendojnë planifikimin me qëllim që, menjëherë pas rekrutimit të kandidatëve për ushtarë profesionistë, të fillojë Stërvitja Bazë dhe Stërvitja Individuale e Avancuar e tyre.

2.3 Kriteret për rekrutimin e ushtarëve profesionistë

Kandidati për ushtar profesionist duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- 2.3.1 Të jetë me shtetësi shqiptare.
- 2.3.2 Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepër penale.
- 2.3.3 Të mos jenë në ndjekje penale.
- 2.3.4 Të mos ketë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose veprimtarisë në administratën publike me vendim gjykate.
- 2.3.5 Të mos jetë në proces gjykimi penal nga Gjykata
- 2.3.6 Të jetë në moshën 19-30 vjeç.
- 2.3.7 Të ketë kryer arsimin e mesëm ose të lartë.
- 2.3.8 Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtar profesionist nga SUQU.
- 2.3.9 Të ketë kaluar testin fizik dhe atë intelektual.
- 2.3.10 Kandidatët për ushtarë profesionistë të planifikuar për kompletimin e forcave të luftimit dhe mbështetjes së luftimit, të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt mbi 165 cm për femrat.
- 2.3.11 Kandidatët për ushtarë profesionistë të planifikuar për kompletimin e forcave të mbështetjes me shërbime, të kenë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat.

2.4 Procedurat e aplikimit për ushtar profesionist

Kandidatët që dëshirojnë të shërbejnë vullnetarisht në FA si ushtarë profesionistë, do të aplikojnë për këtë qëllim në Qendrat dhe Stacionet e Rekrutimit. Për këtë, ata plotësojnë pyetësorin dhe formularin e aplikimit Nr1, Nr 2 (bashkëlidhur këtij dokumenti) dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme dhe afatin e paraqitjes në QPR për vijimin procesit të pranimit, testimin e përzgjedhjes për ushtar profesionist.

2.5 Dokumentet e nevojshme për regjistrimin e kandidatëve për ushtarë profesionistë

Kandidatët për ushtarë profesionistë paraqesin në Qendrën ose Stacionin e Rekrutimit të Prefekturës së tyre dokumentet e mëposhtme:

- 2.5.1. Kërkesë me shkrim, në të cilën parashtrohet shkurtimisht origjina e familjes, gjendja shoqërore, arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtar profesionist, njësia apo reparti në të cilin do të parapëlqente për të shërbyer dhe prirjet e tij në fusha të caktuara.
- 2.5.2. Fotokopjen e letërnjoftimit ose pasaportës
- 2.5.3. Çertifikatë familjare.
- 2.5.4. Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12
- 2.5.5. Fotokopje të diplomës së arsimit të mesëm ose të lartë të noterizuar dhe të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale/Rrethit.
- 2.5.6. Dokument për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuar.
- 2.5.7. Dëshmi penale (deklarata përkatëse).
- 2.5.8. Vërtetim se nuk është në proces hetimi nga prokuroria.
- 2.5.9. Vërtetim se nuk është në proces gjykimi penal nga gjykata.
- 2.5.10. Rezultatin e testeve dhe ekzaminimeve mjekësore nga SUQU.

Qendra ose Stacioni i Rekrutimit vlerëson dhe verifikon nëse dokumentacini i paraqitur nga kandidatët është sipas kërkesave ligjore për pranimin në FA. Dokumentat e kandidatëve të cilat vlerësohen të rregullta sipas kërkesave të mësipërme, përcillen në QPR, për vlerësim dhe vijimin e procedurave të kontrollit, testimin dhe përzgjedhjes së kandidatëve që kanë aplikuar për ushtarë profesionistë.

2.6 Kontrolli, përzgjedhja dhe pranimi për ushtarë profesionistë.

- 2.6.1. Testet dhe ekzaminimet mjekësore të kandidatëve për ushtarë profesionistë, kryhen nga Spitali Ushtarak Qendror Universitar i Forcave të Armatosura në bazë të Rregullores së Vlerësimit të Aftësive Fizike e Shëndetësore të shtetasit dhe ushtarakut të Forcave të Armatosura.

- 2.6.2. Testet dhe procedurat e testimi për pranimin e kandidatëve për ushtarë profesionistë në FA, janë përgjegjësi e QPR.
- 2.6.3. Procesi i kontrollit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për ushtarë profesionistë do të kryhet në Qendrën e Personel-Rekrutimit sipas këtyre kërkesave:
- 2.6.4. Përveç kontrollit mjekësor të realizuar në SUQU dhe të pasqyruar në dokumentacionin e dorëzuar nga secili prej kandidatëve, QPR bën kontrollin e aftësive fizike në tre disiplina: (ulje-ngritje me forcën e krahëve për kohën dy minuta, palosje-shpalosje për kohën dy minuta dhe vrapim 3000 m).
- 2.6.5. Kandidati për ushtar profesionist, duhet të arrijë të paktën 60 pikë për të çdo disiplinë të përgatitjes fizike nga 100 pikë të mundshme veç e veç.
- 2.6.6. Në testin fizik kandidati/tja duhet të paraqitet me veshje sportive (bluzë e pantallona të shkurtëra/tuta) dhe këpucë sportive (atlete).
- 2.6.7. Në rast mos arritje të rezultatit 60 pikë për çdo disiplinë veç e veç kandidati ndërpret konkurimin e mëtejshëm për ushtar profesionist.
- 2.6.8. Pas përfundimit të testit të përgatitjes fizike shpall listën e rezultateve të arritura.
- 2.6.9. Dy ditë pas kualifikimit në testin e përgatitjes fizike vijohet me zhvillimin e testit intelektual të përgatitur për këtë qëllim.
- 2.6.10. Në testin intelektual, minimumi i pikëve për kualifikim do të jetë 78 pikë nga 155 pikë të mundshme.
- 2.6.11. Pas përfundimit të testit intelektual shpallet lista e rezultateve të arritura.

2.7 Procedura e zgjidhjes së ankesave

- 2.7.1. Kandidati ka të drejtë që, brenda dy ditëve pune të ankohet me shkrim pranë QPR për vlerësimin që është bërë atij në testet e zhvilluara.
- 2.7.2. QPR shqyrton ankesat dhe kthen përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve pune.
- 2.7.3. Procedura e zgjidhjes së ankesave të dokumentohet zyrtarisht.
- 2.7.4. Qendra e Personel Rekrutimit, pas pranimit dhe testimi të kandidatëve për ushtarë profesionistë dërgon me shkresë zyrtare në Drejtorinë e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm, Forca, Brigada, Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes listën emërore të kandidatëve fitues për ushtarë profesionist, të shoqëruara me dosjen (gjithë dokumentacionin) vetëm sipas kuotave numerike të listuara sipas rendit zbritës të klasifikimit, për vijimin e procedurave të mëtejshme.
- 2.7.5. Për çdo rast të mosvijimit të procedurave për titullim dhe emërim në detyrë të kandidatit për ushtarë profesionistë, struktura ushtarake, të shprehet me shkrim për arsyet e mosvijimit të procesit si dhe të njoftohet zyrtarisht për këtë Shtabi i Përgjithshëm i FA.

- 2.7.6. Për rastet e mundshme të përmendura në pikën 2.7.5, QPR dërgon dokumentacionin për kandidatin/kandidatët vijues që janë testuar më parë dhe janë shpallur fitues sipas rendit zbritës, të cilët nuk janë dërguar në strukturat e FA për t'u titulluar e emëruar në detyrë, për arsye të kuotave të miratuara më parë.
- 2.7.7. Për rastet sipas pikës 2.7.6 dhe kur ka kaluar një periudhë me shumë se gjashtë muaj nga testimet e mëparshme, zhvillohet procesi i rritimit të kandidatit/kandidatëve në Spitalin Ushtarak Qendror Universitar vetëm për gjendjen shëndetësore dhe në QPR për përgatitjen fizike.

2.8 Procedurat e titullimit, emërimit të ushtarit profesionist.

- 2.7.1. Pas marrjes së kandidaturave nga QPR, Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA dhe Degët e Personelit në Komandat e Forcave, Brigadave dhe Komandën e Doktrinës dhe Stërviçjes, vijon procedurat për përgatitjen e urdhrin për titullim ushtar profesionist dhe dhënie grade “Ushtar Profesionist i Parë”, si dhe Urdhrin “Për emërim në detyrë të Ushtarit Profesionist i Parë” brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes kandidat fitues për ushtar profesionist, duke dërguar një kopje të këtyre urdhrave në Drejtorinë e Përgjithshme të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA dhe QPR për regjistrimin e tyre në regjistrat elektronikë dhe fizikë.
- 2.7.2. Strukturat e personelit të Forcave, Brigadave, KDS si dhe të njësisë dhe repartëve të vartësisë së Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes, pas firmosjes së urdhrin të titullimit “Ushtar Profesionist” dhe dhënies së gradës “Ushtar Profesionist i Parë”, përgatisin kontratën përkatëse të shërbimit me Forcat e Armatosura.
- 2.7.3. Në Kontratën e shërbimit me Forcat e Armatosura përcaktohet: në rast se Ushtari Profesionist nuk çertifikohet për kryerjen e Stërviçjes Individuale Bazë dhe Stërviçjen Individuale të Avancuar sipas detyrës së tij funksionale nga Qendra e Stërviçjes Individuale në Bunavi, të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, kontrata zgjidhet menjëherë.
- 2.7.4. Kontrata e shërbimit, nënshkruhet (lidhet) midis personit të rekrutuar për ushtar profesionist dhe institucionit të Forcës së Armatosur (përfaqësuar nga Komandanti i Forcës/Brigadës/Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes) ku do të shërbejë ushtari profesionist. Për ushtarët profesionistë që rekrutohen për kompletimin e njësisë dhe repartëve të vartësisë së drejtëpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, kontrata e shërbimit me Forcat e Armatosura nënshkruhet (lidhet) midis personit të rekrutuar, komandantit të njësisë, repartit ku do të shërbejë ushtari profesionist dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.
- 2.7.5. Komandat e Forcave, Brigadave, KDS si dhe njësitë dhe repartet të vartësisë së drejtëpërdrejtë, sipas planit të rekrutimit do të marrin masa për dërgimin e kontingjenteve të tyre (ushtarëve profesionistë) në Qendrën e Stërviçjes Individuale, për kryerjen e Stërviçjes Individuale Bazë dhe Stërviçjen Individuale të Avancuar për specialitetin “Këmbësori”.

- 2.7.6. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (Qendra e Stërvitjes Individuale) për specialitetet e tjera, pas përfundimit të Stërvitjes Individuale Bazë, i dërgon këto kontigjente në Shkollën e Trupës për zhvillimin e Stërvitjes Individuale të Avancuar sipas specialiteteve.
- 2.7.7. Ushtari profesionist do të fillojë kryerjen e detyrës sipas funksionit organik vetëm pas përfundimit me rezultate pozitive të Stërvitjes Individuale Bazë dhe Stërvitjes Individuale të Avancuar.